

INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Qendra e laboratorëve referent

Njësia e mbrojtjes nga rrezatimi

Lënda: Kumtesë nga ISHP për gjendjen e sapokrijuar dhe matjet e realizuara për rrezatimin jonizues (radiacionin) në ajër

Të nderuar,

Instituti i Shëndetit Publik bën ndjekjen e vetive kimiko-fizike në tokë dhe në ujë dhe ndjek rrezatimin në ajër, ujë dhe tokë.

Instituti i Shëndetit Publik disponon me një laborator referent të akredituar me pajisje të teknologjisë së fundit dhe dymbëdhjetë stacione matëse, si dhe punonjës të kualifikuar dhe të trajnuar për monitorimin e rrezatimit jonizues në ajër.

Instituti mat dhe merr informacion në kohë reale (real time) lidhur me rrezatimin e mundshëm në ajër.

Në periudhën nga 7 deri më 14 shtator 2025, sistemi jonë i automatizuar për matjen e rrezatimit në ajër punoi pandërprerë dhe i ndoqi rregullisht të dhënat e të gjitha 14 vendeve të matjes në mbarë Maqedoninë.

Një ndër to është edhe stacioni në Shkup (MKMR-1).

Rezultate për Shkupin (MKMR-1):

Mesatarja për periudhën: 51 nano siverta në orë

Vlera më e ulët dhe më e lartë: nga 51 deri më 69 nano siverta në orë

Sot (14 shtator 2025 në 11:30): 50 nano siverta në orë

Për krahasim: të gjitha këto shifra janë brenda kornizës së fonit natyror të rrezatimit, pra rrezatimit normal natyror që është gjithmonë i pranishëm në mjedisin tonë.

Nuk ka vlera që do të tregonin për radioaktivitet të rritur ose rrezik për shëndetin e qytetarëve.

ISHP njofton se për momentin nuk ka devijime nga vlerat normale referente që do të indikonin për rrezatim, pra rrezatim në ajër.

ISHP dërgoi ekipe të trajnuara nën drejtimin e Inspektoratit e Mjedisit Jetësor, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Shtabit të Krizave, të cilët do të marrin mostra të tokës dhe ujit nga zona e prekur për analiza fizike dhe

kimike, si dhe do të marrin mostra nga çezmat, pusët dhe toka në zonat e prekura për testim për rrezatim të mundshëm jonizues.

Pas analizimit dhe përpunimit të tyre, ISHP do t'i ndajë rezultatet me publikun.

Instituti do të vazhdojë ta monitorojë nga afër situatën në koordinim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe të gjitha institucionet shtetërore kompetente që janë të përfshira në procesin e tejkalimit të situatës. ISHP rekomandon që qytetarët të vazhdojnë t'i ndjekin rekomandimet e Institutit të Shëndetit Publik.

Me respekt,

Njësia e mbrojtjes nga rrezatimi
Institutit i Shëndetit Publik i Republikës së Maqedonisë
Shkup 14.09.2025